Kronikë

Gjirokastër/ Gjenden 2 kallashnikovë në fshatin Bodrishtë, në kërkim poseduesi

Në Gjirokastër, policia ka sekuestruar 2 kallashnikovë në fshatin Bodrishtë, ndërsa qështë shpallur në kërkim poseduesi. Dyshohet se një person i kishte fshehur armët e zjarrit në një banesë të pabanuar dhe për shkak të presionit policor, armët e zjarrit dhe municionin luftarak i kishte hedhur në terren.



Armët e sekuestruara nga policia

Redaksia
16 Prill, 15:20 | **Përditesimi: 16 Prill, 15:31**

Share

Gjirokastër- Policia sekuestruar 2 armë zjarri kallashnikov dhe municion luftarak, në fshatin Bodrishtë në Gjirokastër, të cilat do të dërgohen në Institutin e Policisë Shkencore, për ekspertim.

Shërbimet e Policisë kanë marrë informacion se në një banesë të pabanuar, në fshatin Bodrishtë, një person ende i paidentifikuar kishte fshehur aty armët e zjarri dhe municion luftarak.

SIpas policisë, personi që kishte fshehur armët në banesë për shkak të presionit policor, armët e zjarrit dhe municionin luftarak i kishte hedhur në një kosh mbeturinash.

LEXO EDHE:
Bllokohet grupi i turistëve spanjollë në Kanionin e Nivicës, policia dhe forcat zjarrfikëse shpëtojnë tre turistët (VIDEO)

'Gjatë kontrollit të territorit, në bashkëpunim me punonjësit e pastrim-gjelbërimit, këta të fundit gjetën në një kosh mbeturinash, 2 armë zjarri kallashnikov dhe municion luftarak. Armët e zjarrit do të dërgohen në Institutin e Policisë Shkencore, për ekspertim, për të parë nëse janë përdorur ose jo në ngjarje kriminale të mëparshme', njoftoi sot policia.

Gjithashtu, një grup i posaçëm hetimor, në drejtimin e Prokurorisë, po punon për identifikimin dhe kapjen e shtetasit që posedonte armët e zjarrit dhe municionin luftarak.

Armët e sekuestruara nga policia

S.B/Shqiptarja.com

TAG: Gjirokaster kallashnikov municion luftarak policia e gjirokastres

Komento

Komente

Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

Sondazhi i ditës:
14 Prill, 22:09
A duhet t'u jepet mundësia prokurorëve të SPAK të rikandidojnë?

Po Jo Nuk e di

Lajme të tjera

Kakavijë/ E dënuara me 1 vit burg për vjedhje në Vlorë kapet në kufi! Nën akuzë dhe 38-vjeçari që udhëtonte drejt Greqisë me 11100 euro cash
16 Prill, 13:11

U kap me kokainë, arrestohet 42-vjeçari në Gjirokastër! Dyshohet se do e shiste në doza
15 Prill, 13:35

Auron Tare: 'Where to piss in Gjirokastra?'
Auron Tare
14 Prill, 22:54

Lejuan ndërtime pa leje, detyrim paraqitjeje për kreun e IKMT në Mallakastër, 2 inspektorë dhe 3 efektivë! Pezullohen nga detyra (EMRAT)
14 Prill, 14:26

Memaliaj/ Fshihte armë për llogari të një grupi kriminal, në kërkim 20-vjeçari (EMRI)
14 Prill, 13:09

PERSONAZH/ Ferdinand Makri, mjeshtri i Gjirokastër prej 35 vitesh: Turistët kërkojnë portretet e Enverit dhe Stalinit
Piro Nase
14 Prill, 10:43

Ujërat e egra në Përmet presin garën më të madhe 'Rafting'! 8 ekipe sfidojnë rrjedhën për trofetë e vitit 2025 (VIDEO)
Sokol Dema
13 Prill, 11:11

Gjirokastër/ Digjet makina 'Range Rover' në lagjen Dunavat, nuk dihen shkaqet (VIDEO)
13 Prill, 10:04

Gjirokastra turistike pa strehë për qentë e rrugës, kryebashkiaku: Tenderi dështoi disa herë
Piro Nase
12 Prill, 15:06

AF Luftëtari kampion në Grupin B, sezonin e ardhshëm luan në Kategorinë e Parë
6 Prill, 15:21

VIDEO/ Flakët përpijnë autobusin në dalje të tunelit të Kardhiqit, 'reja' e tymit mbulon zonën! Pasagjerët të trembur, shpëtojnë mrekullisht
5 Prill, 11:49

'Shpëtova nga plumbi', rrëfimi i dhimbshëm i nënës me 3 vajza! Jeta në skamje pas divorcit: Zoti e di si jetojmë
Piro Nase
4 Prill, 16:16

HOROSKOPI

RAPORTO! Chat live me Shqiptarja.com

© 2011 - 2025 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje